




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e (VXI) e Kuvendi të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 29.3.2011 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. Zgjedhja e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete,
3. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 3/1. Raporti financiar për vitin 2010,
 - 3/2. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për zgjerimin e varrezave të fshatit Uglarë,
 - 3/3. Propozim-vendimi për dhënien e pëlqimit për Partneritet publiko-privat në ofrimin e shërbimeve për mbeturina,
 - 3/4. Propozim-vendimi për kompensimin e përkohshëm të familjes së ish Kryetarit të Komunës, Xhemajl Hyseni,
 - 3/5. Propozim-vendimi për autorizimi i Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit edhe për hartimin e Rregullores për kompensimin e ish zyrtarëve të lartë të komunës e të cilët nuk ushtrojnë funksion publik,
4. Të ndryshme,

Seanca filloi punimet në ora 10.10 min

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e Seancës së gjashtëmbëdhjetë ishin:

Anëtarët e Kuvendit
Drejtorët e drejtorive
Kryetari i Komunës
Përfaqësuesit e MPL-së

Përfaqësuesit e OSB-së
Njësia për të Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe
Mediet

Seancën e XVI (gjashtëmbëdhjetë) e hapi kryesuesi i Kuvendit z. Izmi Zeka i cili përshëndeti, anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSB-së, përfaqësuesit e MPL-së, Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, mediet dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Me kërkesë të kryesuesit sekretaria konstatoi se në këtë seancë janë prezent 39 anëtarë të Kuvendit, kurse mungojnë dy: Sabedin Kadriu dhe Dritë Ismaili

Procesverbali

Sadudin Berisha- është një gabim teknik në procesverbal f. 15 jo vend-votim, por vend-gjueti.

Arben Maliqi – faqe 9 jo 75 mijë armë gjuetie, por 35 mijë

Miratohet procesverbali me këto vërejtje

Izmi Zeka- në rend të punës duhet të hyjë edhe një pikë, sepse është emergjente; Është vendim për bartjen e mjeteve vetanake nga të hyrat për vitin fiskal 2009-2010 dhe tejkalmimi i të hyrave nga planifikimi 2010 në vitin fiskal 2011.

Miratohet rendi i punës me vota unanime

2. Zgjedhja e zv/kryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete

Izmi Zeka- këtë pikë e kemi vu në rend të punës, sepse zv/kryesuesi i mëparshëm z. Kadër Hysen zv/kryesues për komunitete ka dhënë dorëheqje, prandaj sot duhet të bëhet zgjedhja e një zv/kryesuesi nga radhët e komuniteteve, sepse bukur gjatë ky vend është i lirë.

Në bazë të ligjit ky post i takon minoritetit turk, të cilin ligj z. Kryesuesi e lexon dhe e sqaron, pas të cilit sqarim z. Kryesuesi e propozon për këtë post, z. Selim Selimin.

Miratohet unanimitet propozimi i kryesuesit të Kuvendit që z. Selim Selim të jetë zv/kryesues i Kuvendit për minoritete.

Pas miratimit të këtij propozim-vendimi, z. Selimi nga karrigia e këshilltarit, ulet në karrigen e zv/kryesuesit .

3/1. Raporti financiar për vitin 2010

Izmi Zeka- e keni të qartë se Drejtoria e Financave ka dhënë raport për 6 mujorin dhe nëntëmujorin, kurse tash është 12 mujori për të cilën periudhë raportin e keni të

kompletuar. Ju i keni të dhënat në raport dhe keni pasur mundësin për të parë se sa mjete kanë qenë të planifikuara, sa kanë qenë hyrat dhe të dalat në përgjithësi në Komunë.

Së pari fjalën do ta ketë drejtori, mandej do ta hapim debatin për këtë çështje.

Nuhi Nuhiu- ky raport është një dokument i cili tregon një aktivitet të shtuar të Qeverisë Komonale edhe pse ne si qeveri jemi konstituuar mjaft vonë, diku më 5 maj 2011 për arsye të zgjedhjeve të stërzgjatura. Për këtë arsye ne tre muajt e parë kemi pasur mjaft vështirësi në inkasim i cili nuk ka premtuar shumë, sepse planifikimi i buxhetit është realizuar për këta muaj deri në 50%. Mirëpo me konstituimin drejtorive dhe stafit dalëngadalë jemi konstituuar dhe në fund kemi dal me një tejkallim të buxhetit prej 4% të hyrave.

Në vijim të fjalës së tij z. Nuhi e sqaroi planifikimin e buxhetit duke i sqaruar të gjitha të dhënat të cilat të dhëna këshilltarët i kanë në raport të punës.

Zijadin Maliqi- gjatë analizës që i kam bërë raportit financiar për vitin 2010 kam parë se për nga aspekti teknik, raporti në përgjithësi është punuar mirë, me përjashtim të disa vërejtjeve të vogla në disa kolona, sepse tek rekapitullimi i shpenzimeve nuk shihen mirë ato rekapitullime. Mirëpo sa i përket anës së menaxhimit të buxhetit për vitin 2010 unë i kam disa vërejtje të cilat do t' i them me radhë.

Mjetet e bartura nga viti 2010 në 2011 sipas raportit janë 510.666,00 euro ose 2.59% si dhe mbi 129 mijë euro të cilat janë realizim i të hyrave më tepër se sa është planifikuar.

Sa i përket pjesës së mbetur tek të hyrat vetanake prej mbi 330 mijë eurove për mua është e arsyeshme, sepse ato mjete grumbullohen gjatë muajit nëntor dhe dhjetor dhe për shkak të procedurave, ato barten në vitin vijues.

Mirëpo për mua është e pa arsyeshme mbetja e mjeteve prej 165 mijë eurove, mjete të grandit qeveritar të cilat sipas Ligjit të financave nëse nuk shfrytëzohen brenda vitit, ato mjete për Komunën humbin, sepse shkojnë në suficit të Kosovës. Gjithashtu janë pak më shumë se 4 mijë euro mjete të mbetura nga viti 2009 të cilat barten në vitin 2011.

Mua më intereson pse dhe si kanë mbetur këto mjete dhe a ka ndonjë shpjegim për këtë?

Sa i përket të hyrave mund të thuhet se është punuar mirë, sepse kemi një tejkallim të buxheti prej 4% , por krahasuar me vitin 2009 ka tejkallim mbi 19% .

Në shpenzimet për mallra dhe shërbime, unë edhe më parë kam dhënë vërejtje se për këtë kategori janë duke i planifikuar mjete të mëdha financiare dhe kjo dukuri është në rritje e sipër, në vend se të jenë shpenzimet më të vogla!

Shpenzim bukur të madh në këtë kategori kemi sidomos tek Administrata Komonale pa arsimin dhe shëndetësinë. Për mua në Administratë Komonale është një shpenzim bukur madh e ai shpenzim është mbi një milion euro mallra dhe shërbime, por kur ia shtojmë kësaj edhe 400 mijë euro obligime të cilat kanë mbetur e janë bartur në vitin 2011, atëherë del afër 1 milion e 500 mijë euro shpenzime i cili shpenzim për mua është shpenzim tepër i madh.

Në mënyrë analitike unë i kam nxjerr disa kategori: një prej kodeve buxhetore në raport është shpenzimet brenda vendit, për pa i ditur obligimet se çka janë? Shuma për këtë kategori është mbi 32 mijë euro. Për akomodim janë 1780 euro, kjo disi është e arsyeshme, sepse ka qëndrime dhe fjetje në Hotel, por mbi 32 mijë euro janë shpenzime vetëm brenda vendit. Nuk e kam të qartë se çka janë këto shpenzime?

Kategori tjetër është shpenzimet jashtë vendit, janë mbi 36 mijë euro, por ne nuk kemi pasur asnjëherë ndonjë raport në Kuvend, por as prej kryetarit për udhëtime jashtë vendit! Te “Vala 900” kam thënë edhe në seancat tjera se në këtë kategori kemi një shpenzim mjaft të madh, afër 27 mijë euro. Unë nuk e di se kush furnizohet me këto mbushje?

Ne në qeveritë e kaluara kemi pasur nga 20 euro mbushje vetëm drejtorët, por tash çmimet e valës janë shumë më të lira, por shpenzimet janë më të mëdha.

Blerja e telefonave është një shifër prej 10.400 euro, nëse këtë shumë e përpjestojmë me 300 del se janë blerë 35 telefona. Nuk e dimë se për kë janë blerë dhe kujt iu janë dhënë?

Kompjuterë, është blerë një shumë e madhe, por as nuk dihet se ku gjenden të vjetrit, por për kompjuterë është një shumë mbi 24 mijë euro.

Pajisje tjera, të cilat nuk kam pasur mundësi për t’i identifikuar janë mbi 94 mijë euro, sipas kodit 13/509, por edhe 60.730,00 euro të kodit 31/690, nuk e di se çka janë kërkoj sqarim?

Furnizim për zyre gjatë vitit 2010 figurojnë se janë shpenzuar mbi 236 mijë euro, kjo më duket një shumë enorme dhe tepër e madhe!

Furnizim me ushqim dhe pije janë mbi 134 mijë euro, mbi 80 mijë euro ishin tek arsimi parashkollor të cilat janë të arsyeshme. Te shëndetësia ishin mbi 20 mijë euro, por nuk e di kush furnizohet me ushqim dhe pije atje?

Te mirëmbajtja e automjeteve është një vlerë bukur e madhe, diku afër 47 mijë euro dhe kam thënë edhe më herët se me këto mjete më mirë të kishim blerë automjete të reja se sa të përdoren disa që janë të vjetra mbi 10 vjet.

Derivate për vetura janë 149 mijë euro.

Dreka zyrtare në bazë të raportit janë mbi 104 mijë euro, të gjitha drejtoritë kanë shpenzime për dreka zyrtare. Unë e kam parë një menaxhim ashtu si duhet vetëm te pjesa e Kuvendit, kurse të tjerat të gjitha kanë tejkalime. Unë pasi që i kam heq ditët e vikendeve dhe festat del se për çdo ditë për dreka janë harxhuar nga 400 euro.

Mandej i kemi dy kode te sigurimi i ndërtesave 50.523,00 është një kod 13/952 edhe sigurimi i ndërtesave tjera dhe këtu janë mbi 45 mijë euro kodi 13/953

Ka edhe plotë gjëra të tjera, por sa i përket mallrave dhe shërbime unë jam ndal në këto çështje.

Mandej pjesa e obligimeve deri më 31.12.2010 të bartura në vitin 2011 dhe gjithsejtë obligime të bartura janë mbi 1 milion e 100 mijë euro e cila është një shumë tepër e madhe kundrejt mjeteve të bartura. Unë mjete të bartura i llogariti vetëm ato 345 mijë euro që janë mjete tona, kurse ato të grandit janë mjete të humbura. Obligimet janë mbi 1 milion e 121 mijë euro, pagat 31.627, nuk e kam të qartë si mundet për paga të kemi borxh, kur ato planifikohen me kohë dhe ato paguhen prej nivelit qendror.

Nuk ka ndodh që për paga të mbesim borxh, prandaj edhe për këtë kërkoj sqarim?

Mallra dhe shërbime janë 615.510 përmbi 450 mijë janë vetëm për Administratën pa arsimin dhe shëndetësinë. Shpenzimet kapitale janë mbi 300 mijë euro dhe sigurisht se këto janë vetëm prej faturave të cilat i ka nxjerr buxheti, por realisht ka shumë e shumë shpenzime të tjera.

Në fund po them se nuk kemi punuar me një nikoqirllëk të duhur dhe të mirë me buxhet të Komunës dhe me mjete të taksa paguesve të banorëve të Komunës së Gjilanit.

Abdyl Aliu- e çmoj dhe e përsëndes punën e këtij raporti të hartuar nga drejtori dhe ekipi i tij financiar. Gjatë fjalës ë tij në vijim z. Aliu pati disa vërejte lidhur me menaxhimin

e buxhetit nga organet kompetente e të cilat ishin kryesisht shpenzime të panevojshme dhe të tepërta sidomos në tejkalim të shpenzimeve për telekomunikacion, mallra dhe shërbime, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime financiare sipas kodeve të ndryshme, etj.

Të gjitha këto vërejtje, më gjerësisht, z. Aliu i dorëzoi me shkrim në sekretari të cilat do t' i bashkëngjiten procesverbalit.

Mimozë Kadriu- grupi parlamentar AAK-së e mbështet Raportin financiar të vitit 2010 me vërejtjet që u than nga zotëri Zijadin Maliqi. Për të mos i përsëritur ato që u thanë po theksoj se e mbështesim këtë raport me ato vërejtje.

Ejup Haziri- në emër të grupit së pari u uroj detyrën e re zv/kryesuesit, z. Selim Selimi, kurse Raportin financiar grupi i PDK-së e mbështet dhe e miraton.

Arben Maliqi – edhe ne në emër të grupit e përshëndesim zv/kryesuesin dhe ia urojmë detyrën e re duke i uruar fat dhe shëndet. Gjithashtu e përshëndesim edhe raportin financiar, përshëndesim drejtorin dhe ekipin e tij të cilët kanë bërë një punë të mirë.

Unë do të përqendrohem rreth sportit, sepse është koha e fundit që investimet të ndodhin në sport me një shumë më të madhe të mjeteve. Jemi të vetëdijshëm se Ministria e Kulturës i ka dedikuar për sport 1 milion e 100 mijë euro e cila shumë nuk është aspak e mjaftueshme, sepse ai buxhet nuk mjafton as për dy sportist kulminant.

Në Komunë e Gjilanit kanë ndodhur disa investime në sport, për të cilat kam konsideratë, por ato kanë qenë investime të gabuara. E kam fjalën për investime të cilat kanë ndodhur në Palestrën e Sporteve, sepse aty është rinovuar nxehja qendrore, por aty së pari ka qenë desh të rinovohet rrethoja e Palestrës, të lirohet rruga për sportistët gjilanas në Palestrën Sportive, pastaj prapa Palestrës duhet të lirohet ajo udhë e cila është e palestrës. Investimet të cilat kanë ndodhur brenda Palestrës edhe ato kanë qenë investime të gabuara, sepse janë bërë investime jofunksionale.

Mandej edhe në Stadiumin e qytetit ka ndodh jo një investim, por një investigim dhe këtu e kam fjalën për reflektorët, sepse këtu ka qenë një dështim. Ka qenë mirë që të planifikohet se ku po investohet dhe çka po investohet? Duhet të investohet në djelmoshat dhe sportistët tanë të cilët do të na përfaqësojnë ashtu siç na ka hije. Të merresh me sport është që të largohesh prej rrugëve të këqija. Unë e lus kryetarin e Komunës që vitin e ardhshëm të ndodhin investime më të mëdha në sport, kryesisht në sportin gjilanas që ato investime të jenë të qëlluara dhe ato investime të përcillen nga njerëzit profesional.

Gjithashtu e përshëndes edhe punën e cila po ndodh në fshatin Kosaq, sepse aty tash po ndodh një mrekulli, sepse aty po rregullohet rruga sipas standardeve.

Ibrahim Neziri- në emër të grupit G-3 i urojmë sukses zv/kryesuesit, por edhe në emër të grupit edhe e mbështesim këtë raport.

Arben Mehmeti- edhe unë në emër të grupit të LDK-së e përshëndes zv/kryesuesin dhe uroj punë të mbarë dhe suksese, por e përshëndes edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Lidhur me raportin kërkoj sqarim të tabela 2, sepse këtu përmendet Komuna e Parteshit në administrim financiar, por unë realisht nuk e kam të qartë se a është ajo Komunë e ndarë në veti dhe përgjegjësi e kujt është për ta menaxhuar në aspektin financiar dhe në atë praktik? Nuk e kam të qartë ajo është Komunë në veti, kurse ne

vazhdimisht në aspektin financiar e kemi Komunën e Parteshit. Është kërkesë e LDK-së që të kemi kujdes, sepse edhe selia e Komunës së Parteshit bartet diku tjetër në mënyrë jo legale, kurse ne merremi vazhdimisht me punë administrative dhe financiare, prandaj duhet të kemi kujdes në këtë drejtim.

Lidhur me raportin në tabelën nr. 6 ku thotë: “ planifikimi dhe realizmi i të hyrave vetanake për vitin 2010” . Këtu shihet të hyrat nga qiraja janë të realizuara 57 % , kërkoj sqarim pse është ky inkasim kaq i ulët?

Tjetër është, të hyrat nga lejet e punës 28.24%, shihet një përqindje e ulët e realizmit !

Në këtë rast duhet pasur një angazhim më të madh dhe përqindja të jetë më e mirë.

Është interesant te planifikimi, sepse në bazë të këtij raporti del se fare nuk ka DKRS ose nuk ka mjete fare për këtë qëllim. Nuk e kam qatë të hyrat në DKRS në planifikim është zero, prandaj kërkoj përgjigje nga drejtori pse është në këtë formë kjo zbrazëti?

Te arsimi është mirë që është planifikimi 142% dhe këtu ka fjalë për lëvdata.

Jakup Bajrami- pasi që z. Zijadini i tha shumë vërejtje në mënyrë kronologjike, unë i kam vetëm dy- tri vërejtje; Së pari te shpenzimet kapitale i kam dy-tri vërejtje të cilat duhet të gjejnë vend kritik në këtë raport. Te kodi 21/300, në të cilin kod janë shpenzuar 150 mijë euro për rrugë të rendit të katërt e cila është një shifër mjaft e madhe, por faktikisht në terren nuk kam parë as dëgjuar se ku janë investuar këto mjete dhe ku janë bërë këto zgjerime të rrugëve?

Mandej disa investime të cilat janë bërë po bëhen në atë aspektin e fuqisë, sepse po i epen përparësi njerëzve të krahut të pushtetit. Unë kam vërejtje për këtë, sepse në fshatin Kravaricë, absolutisht nuk është bërë asnjë riparim i cili fshat e ka një numër bukur të mirë të banorëve me fuqi bukur të mirë ekonomike, por është fshat i lënë anash nga pushteti.

Ai fshat është anashkaluar, sepse as shkollë nuk kanë!

Vërejtje tjetër kam tek shpenzimet e grandeve dhe tejkalimi i pagave të Komunës e cila shumë është afër 9% dhe sipas llogarive del se mbi 26 punëtorë, janë më tepër të sistemuar se sa është e paraparë? Unë kujtoj se në Komunë ka punëtorë të pa mbulesë dhe të pasistemuar në vend të punës! Gjithashtu edhe te mallrat dhe shërbimet ka shpenzimet të pa mbulesë të cilat u thanë ?

Izmi Zeka- ju e keni kërkuar listën e punëtorëve, ne atë iu kemi sjell të të gjithë SHCK, por një gjë do ta hem që, kur ka punë ka edhe harxhime dhe nuk ka nevojë të bëhen krahasime me vitin 2005, 2006, 2007, sepse tash janë trende të tjera të zhvillimit, por edhe harxhimet janë të tjera. Në këtë raport gjërat janë të specifikuara në detale dhe këtu nuk ka asgjë të mbyllur? Këto gjëra do t’ i sqarojë më mirë edhe drejtori dhe zyrtari për financa.

Ilmi Limani- unë iu përshëndes dhe do t’ i përgjigjem pyetjeve një nga një: Zijadin Maliqi ka thënë 510 mijë euro barten, por kjo nuk shkruan në raport.

Pyetje dytë ka qenë pse 165 mijë nuk janë shpenzuar? Nuk janë shpenzuar, sepse ditën e fundit, sepse ditën e fundit Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete 574 mijë euro për Komunën e Parteshit e cila në vitin 2010 ka funksionuar si njësi buxhetore e Komunës së Gjilanit me kod të posaçëm.

Një pjesë tjetër e cila ka mbetur pa u shpenzuar ka qenë tek Arsimi, sepse ministri i Arsimit ka nxjerr një Udhëzim administrative, ku punëtorët e Arsimit duhet të punojnë deri në fund të vitit shkollor, do të thotë deri më 30 qershor, mirëpo Ministria e

Administratës Publike ka nxjerr një udhëzim tjetër në kundërshtim me udhëzimin e parë, sipas të cilit udhëzim nuk na është lejuar të bëhet pagesa nga sistemi i pagave, prandaj pagat kanë mbetur suficit.

Mjetet e bartura i kam ndarë në tri kategori, mjete të bartura nga viti 2009, ato të cilat janë planifikuar dhe tejkallimi dhe kjo shumë është 462 mijë euro.

Firma “Merkatori” e bënë transportin e nxënësve në drejtimin Gjilan- Pejë – Prizren dhe në disa drejtime brenda Komunës.

Kodi 13/132 janë qëndrimet (fjetjet) të cilat kanë ndodh në Hotel.

Te kodi 13/140 janë shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, por ndodh që ndonjë punëtorë nuk i ka futur në kodin e duhur, por kjo nuk është edhe e rëndë, sepse të gjitha këto në substancë janë shpenzime të udhëtimit.

Te kodi 13/143, ky është një kod në të cilin mjetet në mënyrë direkt nuk i merr shërbyesi civil, por janë për udhëtime jashtë vendit të cilat i marrin agjencitë e ndryshme.

Për “Valën 900”, janë vendimet dhe vlen të përmendet se vetëm në inspeksion, çdo inspektori i takojnë nga 20 euro në muaj.

Tek kompjuterët me Udhëzimin administrativ, dihet se sa është vlera e një kompjuteri, por të cilët e kanë edhe amortizimin 25%. Ne shpesh duhet t’ i heqim nga përdorimi, por është një komision i cili e bënë vlerësimin e kompjuterëve.

Furnizim me ushqim dhe pije, dihet se njësia e Arsimit është e ndarë në tri nivele dhe borxhet të cilat i kemi ndarë në vitin e kaluar i kemi dërguar në arsim për t’ i shlyer borxhet dhe në kuadër të asaj janë paguar dhe obligimet që kanë qenë te mallrat dhe shërbimet, por ka pasur edhe në shëndetësi shpenzime të tilla, sepse janë shpërndarë pako ushqimore në vlerë prej 20 mijë euro skamnorëve.

Te sigurimi i ndërtesave e kemi një lëshim teknik, sepse borxhet që kanë qenë nga viti 2009 të cilat janë për Shërbime Publike, por Drejtoria e Emergjencës ka funksionuar me një program buxhetor, kurse në vitin 2010 është ndarë.

U përmend kodi 13/710, vaji i cili dihet se është antifriz, me të cilin automjetet mbushen prej nëntorit.

Në vijim të fjalës së tij z. Limani dha edhe disa sqarime të tjera si është ajo rreth funksionimit të Komunës së Pareshit, qirasë dhe lejeve të punës si dhe funksionimit të bibliotekës, shpenzimeve kapitale etj.

Abdyl Aliu- duhet ta them se nuk jam shumë i kënaqur dhe nuk jam i kënaqur me përgjigjet të cilat na i dha Ilmiu. Lidhur me përgjigjen e parë për “Vala 900” është ai shqetësimi i im, sepse ka rritje në gjysmë vjetorin e dytë. Përgjigja e Ilmiut se telefonat janë roming dhe ata janë paguar në gjashtë mujorin e dytë, unë mendoj se ajo nuk qëndron, sepse ata duhet të paguhen çdo muaj.

Me përgjigjen për shpenzime të vajit nuk jam i kënaqur, sepse vaji nuk është antifriz!

Arben Mehmeti- Unë bëra pyetje për atë që po e lexoj në dokument. Ilmiu e përmendi, bibliotekën, por unë nuk e di se sipas cilit segment planifikohen mjetet. Unë vetëm po e shoh këtu; “planifikimi shkruan DKRS”, nuk ka më tepër, prandaj për mua kjo është diskutabile? Edhe të hyrat nga qiraja, tek pjesa te Stacioni, kanë qenë familje të Dëshmorëve dhe nuk e kam të qartë a kanë bërë ata pagesa?

Zijadin Malqi- unë në fillim të fjalës sime e lavdërova punën e Drejtorisë së Buxhetit duke theksuar se në aspektin teknik është punuar mjaft mirë, si në aspektin teknik dhe në atë analitikë gjërat janë të paraqitura mirë. Ilmiu i dha disa sqarime, por i dha edhe disa sqarime pse janë bërë ato shpenzime, por nuk pati nevojë, sepse pse janë bërë ato shpenzime nuk i din as Ilmiu? Ilmiu e ka bërë këtë raport në bazë të asaj që i kanë arrit të dhënat nga njësitë buxhetore.

Përgjigjet e tij pse kanë ndodhur këto dreka etj nuk janë punë të Ilmiut, sepse atë nuk e ka pyetur askush? Unë e thash mjete të bartura mbi 1 milion me 460 mijë, ato nuk janë mjete të bartura dhe për mua ato kanë humbur.

Ju z. Kryesuese e thatë mos bënë krahasime më vitet e mëparshme, sepse tash po punohet, por duhet ta dini se edhe atëherë është punuar. Është punuar me shumë pak mjete, bile as me gjysmën e këtyre që janë tash. Tek investimet kapitale, as që i përmenda, sepse të punohet, është e mirë për qytetarët. Unë u koncentrova në mallra dhe shërbime ku kemi shpenzime shumë të mëdha, sepse ka pasur mundësi të ndajmë diçka nga këto mjete dhe ta bëjmë edhe një rrugë tjetër.

Ilmi Limani- unë e di që vaji nuk është antifriz, por kodet ekonomike i formon MEF-i Departamenti i Thesarit, nuk ka pasur kod më të afërt për atë shpenzim, prandaj ka qenë desh ta fusim në atë kod.

Nuhi Nuhiu- unë i falënderoj të gjithë ata të cilët e patën fjalën dhe po vërehet se me të vërtetë e kanë përpunuar materialin dhe mua më vjen mirë që opozita bëri kritika ndaj raportit. Mirëpo nuk ishte bash në rregull, sepse nuk u tha se kemi bërë investime kapitale mbi tre milion, prandaj iu përgëzojmë për këtë!

Opozita gjithmonë është për të parë të meta, kurse sukseset dhe rezultatet i themi ne që jemi në pozitë.

Kur është çështja te grandet Zijadini e din shumë mirë se mjetet e grandit nuk dëshiron askush të shkojnë në suficit. Këto gjëra ne nuk i kemi bërë pse nuk i kemi ditur, apo mundur, por nuk na është lejuar që këto mjete t' i lëvizim prej një pozicioni në pozicionin tjetër. Sa i përket të hyrave vetanake është një vetëdije më e mirë e qytetarëve, por kjo është edhe meritë e opozitës, sepse asnjëherë me asnjë gjest nuk ka bërë pengesë, por vetëm e ka bërë inkurajimin e qytetarëve.

Shpenzimet e ndodhura, këto janë ato të cilat kanë ndodhur, sepse nëse një buxhet ka qenë 10 milion, por tash është 20 milion, atëherë edhe shpenzimet rriten, sepse volumi i punës dhe angazhimet janë më të mëdha.

Këtë raport e ka marrë edhe auditimi i brendshëm dhe ai i përgjithshëm, ata do të hyjnë do t' i hulumtojnë të gjithë dokumentacionin, ne nuk kemi pretendime për të fshehur diçka.

Qemajl Mustafa- unë jam shumë i kënaqur me punën të cilën e kanë bërë drejtoritë të tërë SHC, Kuvendi dhe të gjithë ne bashkë, sepse pa një punë pa një punë të përkushtuar dhe të mirëfilltë ne nuk do të kishim mundur ta bëjmë atë tejkalim në inkasim.

Mirëpo kjo nuk jep komoditet dhe unë pajtohem me atë qasjen parimore të Zijadinit që nëse inkason më shumë, nuk na jep arsye që të shpenzojmë pa kritere, pa koncept dhe pa përcaktim buxhetor. A ka pasur ndonjë derdhje në shpenzim, sigurisht që ka pasur, a ka pasur mundësi të bëhen kursime, sigurisht që në disa kode ka pasur disa mundësi. Miro kjo nuk mund të bëhet ideale dhe absolutisht nuk mund të arrijmë në kufij ideal.

Edhe buxhetin qendror nuk e bëjmë idealist për shkak të fazës në të cilën po zhvillohemi, sepse ky është një tranzicion me shumë të panjohura përbrenda një viti fiskal dhe këto të panjohura bëjnë që të ikim nga pak në të majtë dhe djathtë !

Ne kritikohemi vazhdimisht me qëllimin më të mirë që faza e ardhme të jetë më rregulluare edhe në inkasim, por sidomos në shpenzim të parasë.

Unë po them një fjali që e tha drejtori se me rritjen e kapaciteteve, do të duhet të rriten edhe shpenzimet ani pse tendencat e Fondit Ndërkombëtar janë edhe për në qendër edhe për buxhetet komunale të stagnojnë në këto kategori. Mirëpo në anën tjetër kjo bie ndesh me tendencën e përhershme se shërbimet qysh janë, shërbimi i sigurimit të objekteve, i pastrimit të hapësirave të kalojnë dhe të paguhën nga kodi i mallrave dhe shërbimeve.

Ju e keni parë se neve na kushtojnë gati dyfish po të njëjtat kategori dhe po t' i kishim pasur të punësuar prej kodit të pagave do të kushtonin gjysmë për gjysmë.

Ne kemi pasur përvojë në të kaluarën, sepse kur i kemi pasur rojet fizike këtu na kanë kushtuar 60-70 mijë euro, por kur kanë kaluar në kompani kemi shpenzime 120 mijë euro e më tepër.

Më duket se nuk është shpjeguar mirë, çështja e telefonisë, por unë e di se një vendim e kemi marrë qysh në fillim për kompensim të telefonisë mobile në një pjesë, mbushje për zyrtarët e lartë, për drejtorët, shefat, menaxherët e sektorëve. Sektorët e ndjeshëm kanë që të gjithë, kanë pylltarët, zjarrfikësit etj.

Unë kam pas formuar një komision për të konstatuar gjendjen e kompjuterëve me mjete përcjellëse në Komunë dhe ka pas dal se gjysma e kompjuterëve nuk janë funksionale e të cilat do të duhej të kalojnë në përdorim të dorës së dytë ose tretë. Prandaj është e nevojshme që pajisjet teknologjike të ripërtërihen për t' i përmbush kërkesat e shërbyesve civil. Në Kadastër janë kërkuar 3-5 kompjuterë me karakteristika të veçanta të cilët kushtojnë. Furnizimet për zyre më bërë përshtypje ajo shumë aq e madhe, prandaj edhe unë e kërkoj një sqarim. Mirëmbajtja e automjeteve gjithashtu mu duk e lartë 40 mijë euro, sepse del sa ma shumë se një mijë euro ka kushtuar mirëmbajtja e një veture.

Derivate për vetura është një ngatërresë shumë e madhe, sepse kurrë në Komunë nuk është harxhuar më shumë se 35 deri 38 mijë litra. Këtu është një ngatërresë nuk janë për vetura të shpenzuara karburante 100 mijë euro, sepse shpenzime për karburante ka edhe për gjenerator dhe për ngrohje.

Dreka dhe darka zyrtare, shumica janë manifestime, prandaj shumë herë këtë e kemi shtjelluar me drejtorin dhe duhet të thuhet qartë para Kuvendit dhe trupave të tij, se këto janë manifestime zyrtare, festa kombëtare, manifestime kulturore etj. Vetëm për "Flakën e Janarit", kemi pasur 27 mijë euro shpenzime.

Iu falënderoj shumë për qasjen kritike, për punën e mirë e cila është bërë, sidomos tek tendenca që shpenzimet edhe të ulen edhe të korrektohen nga kodi në kod për të mos pasur tejkalime në krahasim me atë që e projektojmë në fillim të vitit.

Në fund mendoj se me koncenzues të plotë do të duhej të miratohej ky raport.

Vërejtjet të inkorporohen në procesverbalin e seancës së ardhshme në miratim të këtij raporti, në mënyrë që me shumë saktësi dhe me përkushtim Drejtoria e Financave t' i merr dhe t' i lexon ato vërejte në mënyrë që raporti i ardhshëm të jetë shumë më në nivel.

Zijadin Maliqi- po lidhem me fjalën e drejtorit, sepse unë nuk jam i motivuar që t' i shoh gjërat vetëm zi. Unë në fillim thash shumë fjalë të mira lidhur me inkasimin i cili është

tejkualuar edhe në krahasim me vitin e kaluar. Kjo është një gjë e mirë, sepse kur inkasojmë më shumë edhe investojmë shumë, ato ne i llogarisim mjete tona.

Nuk pash krejt zi as këto shpenzime, por kërkoja sqarime prej të cilave disa i di, kurse për disa kam pasur mundësi të shkoj te drejtori ose zyrtari financiar dhe kisha marrë sqarime të duhura. Mirëpo unë e di që edhe këtu brenda me veten e vetë thonë pse janë bërë këto gjëra? Por këtu heshtin !

Unë e di se pa shpenzuar nuk ka as punë, por të kursejmë aty ku ka mundësi?

Edhe një pyetje për fund. Është në raport blerja veturave zyrtare, mbi 127 mijë euro, mandej del edhe një xhip dhe një kombibus 91.434.00, nëse ka mundësi një sqarim, sepse 120 mijë euro janë bukur shumë?

Nuhi Nuhiu- unë e bërë një ngacmim që të thuhet pak më me zë sukseset, sepse më duket që u thanë me një vështirësi.

Edhe kryetari u habit pse janë kaq shumë karburante? Shpenzimet për karburante në Administratën Komunale janë shumë më të vogla se sa janë paraqitur. Mirëpo i kemi arsimi 82 mijë euro karburante për bartjen e nxënësve.

Kombin e ka blerë Drejtoria e Shëndetësisë për transport të të sëmurëve nga dializa i cili ka kushtuar 5 mijë euro.

Te automjeti i cili u përmend është i kryetarit dhe qëndrojnë ato fatura dhe shpenzimet.

Është mirë që të debatohet, unë e kam kërkuar këtë, për arsye se dëshirojmë të jemi sa më transparent. Ju lus të gjithëve që të kërkonin informata për çdo shpenzim, derën e keni të hapur?

Gabime ka të kodeve ka nga zyrtarët financiar, por ato kode janë të afërta, por bëhen gabime, kurse ne patjetër duhet ta regjistrojmë ashtu, sepse nuk kemi mundësi për të bërë ndryshime. Çdo vërejtje të juaj e cila është me vend ne do ta përmirësojmë, por kërkoj nga ju që të na ndihmoni.

Izmi Zeka- faleminderit prej të gjithëve të cilët kontribuan dhe dhanë sugjerimet e tyre, prandaj iu lus që ta miratoni këtë raport me vërejtje, të cilat do të hyjnë në procesverbal

Miratohet Raporti financiar për vitin 2010 me 28 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse një ishte abstënim

3/2. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale për zgjerimin e varrezave të fshatit Uglarë

Izmi Zeka- këtë pikë të rendit të punës e kemi debatuar, jemi pajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, por është edhe propozim i komiteteve përkatëse.

Ramiz Ramadani- edhe grupi i LDK-së e ka shqyrtuar këtë pikë të rendit të punës të cilën do ta mbështet, por e kam një vërejtje në adresim të lëndës. Kërkesa e banorëve të fshatit Uglar për zgjerim të varrezave është një pronë publike e cila nuk e ndërron titullarin, por vetëm ndërrohet destinacioni prej një klase tjetër të tokës në varreza e cila në fakt ka qenë desh të trajtohet nga Komiteti për Planifikim Hapësinor e cila gjë nuk ka ndodhur. Vërejtjet ia adresoj kryesueses së komitetit e cila në vazhdimësi ankohet se nuk

po ka lëndë të mjaftueshme, por lëndët të cilat lidhen me këtë fushë neve na kalojnë nëpër komitete të tjera.

Florinë Zymberi- unë vazhdimisht kam dhënë vërejtje dhe gjithnjë jam në kontakt me sekretarinë, por për shkak të punëve urgjente nuk ka pasur kohë që të më njoftojnë. Për këtë rast edhe unë kam qenë e revoltuar, sepse procedurat duhet të shkojnë sipas asaj që ne jemi përcaktuar më parë në mënyrë institucionale, prandaj herëve të tjera duhet të kemi kujdes.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me këtë pikë të rendit të punës të cilën kryesuesi e propozon për miratim.

Miratohet pika 3/2 e rendit të punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit .

3/3. Propozim-vendimi për dhënien e pëlqimit për Partneritet publiko-privat në ofrimin e shërbimeve për mbeturina

Izmi Zeka- është pikë për të cilën jeni njoftuar shumë detalisht, por e cila është debatuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, por edhe materialin e keni, prandaj duhet të ndalemi mirë dhe t' i sqarojmë gjërat.

Veton Nevzadi- Komisioni aksionar i Higjienës në planin zhvillimor të saj ka planifikuar që të kalojë në një sistem më të avancuar të trajtimit të mbeturinave, separimin e tyre dhe riciklimin e mbeturinave.

Kompania “Higjiena” ka nevojë për një kapital të freskët privat, prandaj kemi paraparë që të futemi për mes PPP-së.

Ky partneritet i PPP-së është që kjo kompani të epet në menaxhim investitorëve privat në mënyrë që të shtohen kapacitetet e kompanisë në kuptimin teknologjik, profesional dhe përmbajtjesor .

Në këtë frymë ne kemi të interesuar në kompani austriake e quajtur “ Moser” e cila është interesuar të futet me kapitalin e saj në një menaxhim të përbashkët të Kompanisë .

Atyre iu kemi dhënë mundësinë që të futen në një pilot projekt në lagjen “Dardania” i cili është vlerësuar si pozitiv, pas vlerësimit të bërë nga një Komision i formuar nga kryetari i Komunës. Më pas ata kanë paraqitur kërkesën për hyrje në PPP, të cila materiale i keni së bashku me materialet e tjera për seancë.

Kërkesa jonë ka kaluar në Komitetin për Shërbime Publike, atë për Politikë dhe Financa, prandaj kërkojmë nga ju që të jepni pëlqimin për fillimin e procedurave të nevojshme për të hyrë në këtë partneritet, sipas ligjit të PPP-së.

Sqarime më detale do të na jep edhe kryetari i Bordit të “Higjienës” z. Fadil Osmani.

Fadil Osmani – Kompania “ Higjiena” ka nevojë për investitorë, do të thotë ka nevojë për një kombinim në mes kapitalit ekzistues dhe një investim të PP- së për të qenë shërbimet më cilësore në Komunë të Gjilanit. Kompania “Higjiena” pas luftës ka funksionuar përmes projekteve me të cilat është mbështet prej Komunës.

Do të ishte e mirë, por edhe ka nevojë që pas 11 vjetëve ta kemi një pamje tjetër të qytetit dhe pamje tjetër të Tregut të Gjelbër. Ky nuk është projekt politik, por është projekt zhvillimor i cili është në interes të banorëve të Gjilanit, prandaj një kombinim në mes të

PPP-së tani pas 11 viteve është i domosdoshëm. Është mirë dhe e domosdoshme që ju sot t' i hapni rrugë këtij procesi.

Sadudin Berisha- grupi i anëtarëve të Kuvendit nga LDK-ja që më herët e ka parë të nevojshme që kjo Kompani me mundësitë e saj aktuale të cilat i kanë, nuk mund t' i dal për ballë obligimeve të cilat paraqiten para saj, prandaj mbeturinat që i hedhim ne është e nevojshme të menaxhohen si duhet. Në këtë drejtim një vendim është marrë në muajin tetor, apo nëntor të vitit të kaluar për themelimin e komisionit për vlerësim të aseteve, jo në kuptim të thjeshtë të vlerësimit të aseteve, por të për të ardhë deri tek një e dhënë financiare buxhetore çfarë është tek ajo kompani me mundësitë e shikimit për të hyrë në PPP.

Në këtë drejtim LDK e mbështet duke kërkuar rigorizisht që të respektohet ligji sistemor, që rregullon këtë fushë të PPP-së dhe ligjet tjera sistimore që ndërlidhen me këtë fushë. Unë besoj se një gjë e tillë është e nevojshme pa paragjykuar absolutisht se kush do të jetë fitues në investime. Ne nuk paragjykojmë, janë kriteret kushtet dhe mekanizmat të cilat duhet të respektohen me rastin e udhëheqjes së procedurave për lidhjen e një mundësi për PPP-në.

Kjo është në interesin e Gjilanit, por një qartësim Kompania "Higjiena" juridikisht është një subjekt regional i cili juridikisht e përfshinë Vitinë dhe Dardanën, mirëpo Vitia në mënyrë arbitrarë është larguar nga kompania dhe de jure nuk është pjesë e kompanisë, de facto është e shkëputur, interesimet e pjesës së Higjienës nga Dardana, vlerësohet se edhe ata do të jenë të shkëputur prej neve, kështu që ka të bëjë me atë pjesë të kompanisë e cila e mbulon atë pjesë të Komunës së Gjilanit.

Përfundimisht LDK e mbështet këtë projekt në interes të Komunës së Gjilanit.

Ejup Haziri- ajo të cilën unë desha ta them është se ne para një kohe, këtu në këtë Kuvend e kemi krijuar një komision për vlerësim të aseteve. Ai Komision është marrë me profesionalisht me punën e Higjienës dhe për të qenë më konstruktiv, unë kërkoj që aty ku janë të gjitha subjektet politike dhe ata ta japin mendimin e tyre, se secili çka mendon për këtë punë? Ne vet si Kuvend e kemi miratuar një vendim të tillë e kemi krijuar atë Komision dhe për mos të pasur debat të stërzgjatur, ata të japin informacione dhe secili në këtë mënyrë paraqet qëndrimin e grupit.

Sokol Haziri- unë së pari e uroj zv/kryesuesin duke iu uruar suksese dhe punë të mbarë! Unë po dal tek tema për të cilën po flasim, por me të drejtë e tha z. Ejupi se kryesuesi i Komisionit do të duhej të paraqet një raport, mirëpo deklaratimet tona në emër të grupeve janë deklarime politike. Ne si AAK e mbështesim vendimin për të hyrë në PPP me sqarimet e nevojshme për opinionin se këtu nuk ka shitje, nuk ka largim të punëtorëve dhe nuk ka procedura pa tenderim dhe të gjitha do të jenë të monitoruara mirë dhe të bazuara në ligje. Ne e mbështesim një vendim të tillë, por nuk do të rrimë duarkryq, por do të jemi aktiv dhe monitorues gjatë gjithë kësaj faze, sepse de facto me kapacitet të cilat i ka kjo kompani nuk i ka mundësit për mbijetesë. Unë këto gjëra nuk i kam ditur, por gjatë aktivitetit që e kemi pasur kemi marrë informacione të mjaftueshme dhe definitivisht jam bindur që kështu nuk mund të ecet më tutje dhe përfundimisht duhet të kthjellemi, sepse kemi hyrë në procese të reja dhe kemi hyrë në një sistem të ri, prandaj ne e mbështesim këtë nismë.

Riad Rashiti- z. Rashiti para anëtarëve të Kuvendit, në emër të Komisionit e paraqiti një informatë të cilën e dorëzoi me shkrim në sekretari e cila do të jetë pjesë e procesverbalit.

Arben Maliqi- më vjen mirë që PPP, po fillon mbarë dhe mirë, sepse po të hiqen mbeturinat nga shtëpia nuk gjë më të mirë. Edhe unë në emër të grupit tim jemi për këtë projekt, sepse kur është për edhe opozita nuk ka shumë për të biseduar, sepse është projekt tejet i qëlluar. Mirëpo i kemi edhe disa pika të cilave duhet t'iu përmbahemi.

Së pari ne mendojmë se nuk duhet bërë largimi i asnjë punëtori i cili është i punësuar në atë kompani. Të gjitha grupet kemi marrë vërejtje nga sindikata, por mendoj se nuk kanë të drejtë, sepse unë besoj në këtë kompani se do të jetë një kompani serioze dhe t'iu kryejë punët ashtu siç duhet. Pilot- projekti ta them sinqerisht i cili ka ndodh në lagjen "Dardania" është një shenjë pozitive që më në fund kanë filluar të ndodhin gjëra të mira në Komunën tonë.

Zijadin Maliqi- unë jam edhe anëtar i Komitetit për Shërbime Publike, prandaj edhe ne si komitet e kemi shqyrtuar këtë lëndë dhe e kemi rekomanduar në KPF. Unë edhe atë ditë, por edhe sot po e them se nuk ka nevojë t'ia themi emrin se cila kompani do të jetë përfituese. U tha edhe më herët për "Moser" grupin, por kjo ka qenë në atë projekt – pilotin, prandaj duhet shkuar sipas procedurave ligjore.

Ne si grup i LDD-së e përkrahim këtë projekt.

Izmi Zeka- ne nuk do të paragjykojmë dhe procedurat do t'iu zbatojmë ashtu siç duhet dhe për çdo gjë, Kuvendi do të vendos. Ne në Gjilan po e bëjmë një hap të cilin ende nuk e ka bërë askush në Kosovë.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi e propozon për miratim këtë pikë të rendit të punës.

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 3/3 e rendit të punës.

3/4. Propozim-vendimi për kompensimin e përkohshëm të familjes së ish Kryetarit të Komunës, Xhemajl Hyseni,

Izmi Zeka- ne jemi dakorduar në KPF që familjen e ish kryetarit të Komunës ta kompensojmë me një shumë prej 500 euro për këtë vit kalendarik, për të cilin rast i keni materialet e kompletuara.

Sadudin Berisha- ne e mbështesim vendim dhe faktikisht ka qenë nisma e LDK-së për këtë çështje, mirëpo në vendim thuhet: "për zbatimin e këtij vendimi duhet të kujdeset kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-së Gjilan". Nuk është kjo standard, sepse duhet të jetë për vendimin kujdeset dhe e zbaton kryetari i Komunës dhe aty përfundon çdo gjë. Mos të ketë konflikt të interesave, njëri e monitoron tjetri e zbaton?

Izmi Zeka- ka qenë qëndrim i shfave të grupeve që kryesuesi i Kuvendit të ketë kujdes se a po zbatohen vendimet e KK-së. Kjo është aspekt teknik ne mund ta heqim pa asnjë problem.

Arben Mehmeti- atë që do ta them nuk ka të bëjë asgjë me këtë vendim, por ne jemi marrë vesh në parim dhe është rregull normale që kryesuesi i Kuvendit e ka obligim ligjor të përkujdeset për vendimet e këtij Kuvendi. Kryetari i Komunës është organi më i lart ekzekutiv, ka për obligim për t' i zbatuar vendimet e Kuvendit, por kryesuesi ka të drejtë për ta kthyer në Kuvend dhe për të dhënë sugjerime se ndonjë vendim nuk po zbatohet drejt. Propozim ka qenë i imi i cili bazohet në shumë rregulla, por është edhe model për komuna të tjera për ta aplikuar.

Arben Malqi- për habi të gjithëve po duhet që të ndodh diçka për të marrë hapa të tillë. Singerisht është mirë që ta çmojmë njeriun sa është gjallë, sa është këtu në Kuvend, i kujt do qoftë ai kryetar dhe mos ta lëmë anash si na ka ndodh me ish kryetarin Xhemajl Hyseni i cili qe tri vjet ka qëndruar jashtë. Mos të ndodh kjo edhe në raste të tjera, kjo të jetë një pësëm për mësim ! Për këtë arsye duhet të jemi të kujdesshëm, jo të ndodh tragjedia, pastaj të merremi me te?

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi kërkon miratimin e kësaj pike të rendit të punës?

Miratohet pika 3/4 e rendit të punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

3/5. Propozim-vendimi për autorizimi i Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit edhe për hartimin e Rregullores për kompensimin e ish zyrtarëve të lartë të komunës e të cilët nuk ushtrojnë funksion publik,

Izmi Zeka- në KPF e kam marrë një qëndrim që të autorizohet Komisioni i cili ka qenë për ndryshime statutare që ta nxjerrë një rregullore për kompensimin e ish zyrtarëve të lartë të Komunës të cilët nuk ushtrojnë funksion publik.

Kjo e pikë e rendit të ditës vet po sqaron se fjala është për funksionarët publik, të cilët kur të largohen nga pozita, nuk ka pasur përkujdesje askush. Me këtë rregullore institucionalizohet çështja e njerëzve të cilët janë në funksione të larta politike.

Rregulloren si draft e bën ai komision , kurse ne do ta debatojmë në Kuvend.

Ejup Haziri- duhet të precizohet saktë se cilët janë ata zyrtarë të lartë, sepse 33 zyrtarë të lartë janë këtu në sallë.

Izmi Zeka- është fjala për funksione publike, jo për zyrtarë.

Qemajl Mustafa- sipas mendimit tim edhe formulimi nuk është ashtu si duhet, prandaj unë do të them që kjo rregullore do të duhej për ta trajtuar mundësinë e angazhimit të atyre zyrtarëve, cilët do që ne i kualifikojmë si fokus grup, për angazhimin në punë nëse ajo është e mundur, por nëse nuk është e mundur, atëherë të thuhet: “ dhe kompensimin”.

Izmi Zeka- kush jeni që të autorizohet komisioni i cili i ka bërë ndryshimet statutare për ta bërë hartimin e kësaj rregulloreje?

Miratohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 3/5 e rendit të punës

3/6- Vendim për bartjen mjeteve nga të hyrave vetanake për vitin fiskal 2009 dhe 2010 si dhe tejkalimi i të hyrave të planifikuara nga viti fiskal i vitit 2010 në vitin 2011-04-

Kryesuesi e propozon për miratim këtë pikë të rendit të punës

Miratohet pika 3/6 e rendit të punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Të ndryshme

Sokol Haziri- pikën të cilën e patëm, ajo kaloi, por kam një vërejtje se mjetet të cilat i dedikohen Kuvendit janë të gjitha zero, por po dalin disa shpenzime për të cilat nuk po di se kush po i kompenson? Më tutje në planifikimet buxhetore, në rishikimin buxhetor, drejtori ta ketë në konsideratë këtë çështje:

Kam vërejtje, tek komisioni të cilin e kemi formuar herën e kaluar për formimin e Këshillave të fshatrave dhe vendbanimeve, sepse ka dal vështirësi teknike, sepse jemi 8 anëtarë, prandaj duhet të plotësohet edhe me një anëtar. Ne kemi menduar për shkak të mbështetjes që duhet ta kemi nga Administrata Komunale, kemi menduar që anëtar i 9 i këtij komisioni të jetë z. Sadri Arfi.

Miratohet me vota unanime propozimi i z. Sokol Hazirit që edhe Sadri Arifi të jetë anëtar i Këshillit të fshatrave dhe vendbanimeve .

Ibrahim Neziri- do ta njoftoj Kuvendin se grupit të G-3 i bashkohet edhe një anëtar i Kuvendit, nga radhët e KDTP-së, z. Selim Selimi.

Rashit Sahiti- pyetja e parë e imja është për kryesuesin. Na janë premtuar të gjithë anëtarëve të Kuvendit llap-topët, çfarë ka ndodhur deri më tani dhe a do të realizohet ai premtim?

E dyta pagat tona më duket se janë shumë fyese a ka mundësi të bëhet ndonjë rritje? E treta është se unë më parë në këtë Kuvend e kam pas kërkuar një vizitë në ndonjë shtet fqinj e cila është prit me kënaqësi, të cilin e ka pas premtuar edhe kryetari, por ende nuk është realizuar ?

Pyetja e fundit është për kryetarin. Para një kohe Komiteti për Pronë e ka dhënë një leje për një objekt lëvizës ose montazh në hyrje të Mireshit, përballë Restaurantit “Ahishta”, mirëpo aty po vërehet se është një pompë benzini. Ai është dhënë ajo leje për objekt lëvizës apo për pompë?

Abdyl Aliu- z. Aliu në fjalën e tij nën të ndryshme pati dy-tri vërejtje: e para ishte përkitazi me disa shtylla të metalta të cilat janë vendosur para Komunës të cilat i pengojnë qytetarët, kurse vërejtje tjetër ishte ajo lidhur me emërtimin e Shkollës Fillore në Zabelin e Sahit Agës, për të cilin rast disa individ po mbledhin nënshkrime të paautorizuara dhe po bëjnë ndasi në mes të banorëve të lagjes. Mirëpo të gjitha këto vërejtje z. Aliu i dorëzoi me shkrim në sekretari të cilat do t’ i bashkëngjiten procesverbalit.

Shukrie Rapuca- kjo është hera e parë që unë plotësisht pajtohem me opozitën dhe mendoj se çdo gjë që do të shtoj vetëm do të rrënohet, me përjashtim të asaj që edhe një komunitet tjetër i cili jeton aty me shumicë, po ashtu ka paraqit edhe një kërkesë.

Këto gjëra janë në kundërshtim të plotë me kulturën tonë qytetare dhe banorët e asaj lagjeje dhe është e palogjikshme të dalin dy kërkesa prej dy komuniteteve, prej të cilave asnjëra nuk kanë bazë. Unë mendoj se plotësisht ka të drejtë Abdyli, sepse shkollës dhe shkollave duhet vënë emrin e ndonjë personi i cili është sinonim i dijes dhe kulturës dhe arsimit në gjuhën shqipe.

Izmi Zeka- çështja e kompjuterëve ka përfunduar, ato shpejtë do t' i marrin këshilltarët. Për paga, unë e kam dërguar dhe një shkresë edhe kryeministrit edhe ministrit të PL dhe të gjithë faktorëve relevantë të Republikës së Kosovës.

Për vizitën e cila është kërkuar do të vendos kryetari.

Emërtimi i shkollave nuk është çështje e mëhallëve, institucioni propozon, më vonë drejtorja dhe Ministria e Arsimit. Këto janë procedura nuk vendosin individët, por vendosin mekanizmat e tjerë siç është e paraparë.

Qemajl Mustafa- unë e kuptoj plotësisht shqetësimin e njerëzve të asaj ane dhe e vërtetë është kjo që po thotë Izmiu se nuk vendosin individët as mëhalla. Mirëpo problemi është që individët e bëjnë sherrin. Individët kanë dal, po agjitojnë, po mbledhin nënshkrime dhe po e polarizojnë lagjen, por nesër do të bëjnë gjëra të tilla edhe në lagje të tjera.

Për ta ndal këtë trend unë jo rastësisht, sepse ju keni themeluar një komision i cili do ta hartojë një rregullore, të shkurt dhe të mirë për mënyrën se si do të bëhet emërtimi i institucioneve shkollore, të kulturës dhe institucioneve të tjera publike, rrugëve dhe shesheve. Ne duhet ta sanksionojmë me rregullore dhe individët më nuk do të kenë vend. Nëse në rregullore thuhet qartë kush mund ta bartë emrin e një shkolle, profilin e njerëzve të cilët do ta bartin emrin e një shkolle apo institucioni, atëherë avullohen tendencat individuale dhe parciale selektive e fisnore.

Izmi Zeka- pajtohem me atë që e tha z. Abdyli dhe shtyllat të cilat janë vendos para objektit të Komunës të cilat i pengojnë qytetarët të largohen, sepse nëse duhet ndërprerë komunikacioni, atë duhet ta bëjë policia.

Ju lus që a jeni që të merret vendim që të largohen këto shtylla?

Drejtorja e shërbimeve publike, autorizohet që brenda një afati t' i largojë ato shtylla !

Miratohet me vota unanime ky propozim

Me këto vendime seanca e gjashtëmbëdhjetë i përfundoi punimet.

Seanca përfundoi në ora 14.45 min

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA